

Tretur në natë

Ajete Sh. Beqiraj

TRETUR NË NATË



Vatra

Mike
A që dëgjuar ndonjëherë
Të vritet zemra
Vetëm pse dashuron
A që mësuar si vetmohet gruaja
Pa u nusëruar mirë

TRETUR NË NATËN E POEZISË

ese e vogël

Të kërkosh të rrëfesh dhembjen tënde, gëzimet e tua, fatin vetë në tempullin e poezisë është një besim i vërtetë dhe singëritet ndaj njerëzve përtej tempullit. Poezia kështu shndërrohet në një forcë hyjnore ku vetmija jote copëzohet nëpër të gjithë si kristale drite dhe prej andej të rikthehen vezullime ndjenjash e persiatje nga më të bukurat. Emocione të tilla po ndillja, teksa po lexoja poezitë e reja të Ajete Sh. Beqirajt, poete kosovare.

Duket sikur s'ka rëndësi se ku jeton poeti, por unë do të këmbëngulja se ka rëndësi për poezinë. Kosova është truall i poezisë dhe me të drejtë Poeti i Detit Tonë i quan kuajt e Kosovës si vëllezër të Pegasit.

Kuajt e Kosovës janë koha dhe kënga të ngarkuara me ëndrrat dhe mundin, ndërsa shtegtojnë karvan drejt ardhmërisë që lëkundet si një pllajë ku po mugëllon drita.

Poetja Ajete Sh. Beqiraj është një nga kalorëset e bukura, e kapur pas jeleve gjithë hënë të vargjeve dhe trokon, trokon dhe pelerinën ja përhap era nën yje mbi barin plot vesë, lotë dhe përshkënditje gjaku. Me vete ka marrë si pajime brought për të mbërritur atje ku pret fëmijëria ose singëriteti që megjithëse shpesh i mashtruar dhe i zhgënjyer, është njerëzor dhe si i tillë, duhet pranuar, edhe duhet dashur.

Duhet të mësohemi të duam edhe humbjet tona, që

ndonjëherë na bëjnë më të pasur.Për të më besuar,mund të lexoni poezite e A-Jete-s, që pranon të tretet në natën e të gjithëve për të qenë pjesë e dashurisë së të gjithëve. Dhe kështu poezia arrin të bëhet lumturi në muzg,në cilindo lloj muzgu. Kurse zemra e kalit me flatra qenka varkë mbi dallgët e ndjenjave që u ngjajnë vargjeve...që do të lexoni.

VISAR ZHITI

Prolog

Adhurim

*Edhe sikur në mua të shkrepthe dielli
Yjet të shëndrisnin brënda syve të mi
Do i shkëmbeja me dashurinë njerëzore
Bukuria dhe rinia veniten në plequri*

*Sikur fytyra ime lirismin e hënës të zbehte
Bukuria e shtatit engjëjt të afronte
Do të dëshiroja të ruaj besimin
Drita e shenjtë zemrën të ma praronte*

*Thesaret do t'i falja me të dyja duart
Sikur ta dëja gjuhën e hënës e të diellit
Të shpreh mirënjohjen për prehjen hyjnore
Në të gjitha gjuhët e tokës dhe të qiellit*

*Bukurinë do falja për dritën e mëndjes
Dlirësinë e shpirtit do shkëmbeja me rininë
Për një vend të vogël në dy botërat
Ku do ta adhuroja përgjithmonë perëndinë*

Shkurt '98

Elegjitë brenda meje

Baba

*Pa të pllakosur errësira e varrit
Drita hyjnore ta praroi trupin
Dyert e qiellit shpirtit ju hapen
Pranë Zotit do jesh deri në përjetësi
Unë dhe nëna tash kaq vjet
Kështu mashtrojmë njëra tjetrën
Por trupi ende të prehet ndër varre
Unë e ndjej e ajo e di*

*Prandaj vajtojmë orë e çast
Trupin që ta ka dergjur varri
Kuja e shpirtit tonë të djegur
Në zemër gdhendi motin kobzi
Ndonëse shpirti i zhuritur
Të ka falur Zotit të Madh
Qajmë me lotë zemrën e madhe
Që ta ka tretur dheu i zi*

Vajtim në natë

*Xixëllonja që vini
Bashkë me pranverën
Ua kam lakmi dritën në natë
Do të desha edhe unë
Të kem një fanar
T'më bëj dritë njëherë
Në këtë rrugë të gjatë*

*Ju flutura të bukura
Që hareshëm sjellni verën
Ndaloni njëherë
Edhe në kopshtin tim
Fluturoni përreth
Trëndafiles së vyshkur
Ndoshta do t'ngreh kokën
Në ju do të gjej shpëtim*

*Qyqe moj e zeza
Netëve kur të fluturosh
Në dritaren time
Ndalo njëherë shikimin
Nën llambën e ndezur
Do t'më shohësh Qyqe
Tek vajtoj si ti
E vetmuar mjerimin*

Përplasje

*Fidan i njomë isha
Kamxhiku i tufanit
Vringëllonte egërsisht
Filizat fshikullonte
Bisqet e bulëzuara
Xhveshte mizorisht*

*Bora në atë pranverë
Sytha e gjethe në degë
M'i ngriu rrënjësisht
Frutat m'u thanë në lulim
Kur trunqu I tij përplas
Pwrtoqy përjetësisht*

?!

*Në udhëkryçin e jetës
Këmbkëputur kur mbeta
Lëmoshë kërkoja vetëm pak lumturi
Pas çdo zgjimi në mjerimin tim
Kërkoja përgjigjet e pyetjeve
Përse u linda
Përse jetoja
Përse vdekja më harronte*

Mjellma Martire

Muzg

*Mjergull Mbi Moçal
Mëllenja Me Mesazhin
Monedha e Mortjes
Mburojë Mëkatarësh*

*Murgesha e Manastirit
Mes Mureve Me myshk
Mbyllur Me Mote
Mbërtheu
Mushamanë e Murrme
Me Myk Mbuluar
Mbështollë Mishin
Mbeti
Mumje e Muzeut Mizor*

Matanë

*Muaj Maj
Mimozat Mugullonin
Muzat Më miklonin
Mua
Mjellmën Martire*

Moshë

*Kur nga trunqu i jetës
U shkëput një gjeth
Dhe në parzmën time
Pikoi si lot
Në faqen e zverdhur
Mynxyrën time
Heshtazi shikova
Por qot mblodha lotët
Si copëza qelqi
T'ngjes pasqyren xhamthyer
Të lumturisë sime*

05 Gusht '98

Dashnorja e vetmisë

*Një pëllumb i përgjakur
Një rreze e thyer
Një yll përtokw i përplasur
Në çerdhen e zemrës sime
Prore gjejnë strehë*

*Se pika gjaku
Rreze të thyera
Yje të shuar
Më përbejnë Mua
Dashnoren e Vetmisë*

Mike

*Po t' më flisje mike
Për mallin e vendlindjes
Me etje do të të degjoja
Edhe unë në atë flakë
Po digjem si qiri*

*Po t' më pyesje mike
Për jetën e mbyllur
Gjatë do të të rrefeja
Historinë e dhëmbshme
Të zogut në kuvli*

*Po t' më pyesje mike
Për shkrumbin e jetimit
Në lotë pasqyrohet
Shpirti im i veshur
Me petkun e zi*

*Mike po t' më rrëfeje
Zjarrin e dashurisë
Edhe unë jam e re
Të kaluarwn do kujtoja
Ty do të të mbaja mëni*

Labirinth

*Në labirinthin e jetës
Gjithë rininë brodha*

*Çdo rrugë përtej
Shkëla e kalova*

*Vjeshtë e pranverë
Viseve shtegtova*

*Tokën përshkova
Nëpër qiiej fluturova*

*Para portës së artë
Gjithnjë u shtangova*

*Se çelësin e lirisë
S'desha të lëshoj nga dora*

01.Dhjetor'98

Më fal meritë

*Koha zhubravit mëndafshin e rinisë
Moshë vyshkë burbuqet e bukurisë
Bekime të tjera mbi mua derdhi Zoti
Oh sa shumë fytyra të lumturisë*

*Mos m'i hedh blazë dritës miqë
Egon mos lejo të t'i verboj sytë
Dekoratë durimi më dha diellin
Mos nguro t'më falësh meritë*

Eja Dashuri

*Përse të perçmojmë udhëkryçin
Në të cilin u gjetëm dikur
Ditët e sjelljes rreth Hiçit
Mund t'i mbyllim me dry
Jemi në nisje drejt cakut
Serish në krahët e tij
Të djeshmen s'mund ta kthejmë
E nesërmja jemi ne të dy*

*Eja të vazhdojmë çastet
Që përgjysmuam në rini
Të shijojmë atë që përvëlon
Të zbusim plagët me lumturi
Jeta mund të jetë shekull
Ndoshta zgjat vetëm një ditë
Eja ndarja po lind falje
Afërsia përtërin dashuritë*

Kot

*Ma mbush zemrën
Hidhërim
Trishtim
Tek më thua
Ne nuk i përkasim një bote
Atje ku je Ti
Jam edhe unë
Ta dish
E fortë është
Dashuria
Sa drita
Muret e shpirtit
Do t'i shndris
Botërat tona
Do t'i bashkojë
Një ditë
Në një*

Dashuria te ti më bart

*Me flatra të bardha
Qepur përmbi krahë
Në shtat vezullimin
Ylber dhe mendafsh
Flokët plot me yje
Dhe pluhur të artë
Me qarrocen e argjendtë
Dashuria te ti më bart*

*Me hovin e pëllumbeshës
Fluturoj në imagjinatë
Me qetësinë e hyjneshës
Befasisht të vi në natë
Nga kurorat e trëndafileve
Petale të derdh në shtrat
Harlisur nëpër rreze
Portat e agimit çdo ditë ti hap*

Kurrë mos thuaj Kurrë

*Kurrë mos thuaj Kurrë
Të lutem singerisht*

*Mos u beto në harrim
I dashur shenjtërisht*

*Do të të tradhtojë
Fati pabesisht*

*Do të të përqesh
Njerëzimi përjetësisht*

*Do të të mallkoj
Zemra ime e brishtë*

*E fyera e thyera
Pena ime e trishtë*

Shpluhurosje

*Syri yt gjurmët e gjakut
Nën penën time do ti shoh
Dashuria mes kujtimesh
Fytyrën time do të gjejë
Shpirti shtegtari do të pohojë
Se ai vetëm mua më njeh
Buza në prekjen e erës
Puthjen time serish do ndjejë*

*Puhija e fatit mbi trupin tim
Harresën do ta shpluhurosë
Engjëlli me Porosinë e Shenjtë
Rrjetën e artë rreth nesh do të endë
Zemra jote vetëm për mua
E këndellur prapë do të rrah
Në kopshtin tonë të mbetur shkrjet
Trëndafili i dashurisë do lëshoj rrënjë*

Vendosmëri

*Endrën e vrarë
Do t'a jetësoj
Dëshirën e qahmotshme
Do t'a përmbush
Me dashuri do të hap
Zemrën tënde të mbyllur*

Unë jam Ajo

*Unë jam e vërteta jote
Jam ëndërra jote e fshehtë
Unë jam dashuria e madhe
E vetmja e murosur në kujtesë*

*Unë jam thellë në gjirin tënd
Sepse unë di të mbes
Pse s'ke fuqi të luftosh fatin
Do t'më përplasësh në harresë*

*Unë e di në vetminë e madhe
Dëshiron heshtur trupin tim
Ndër valet e jetës kur përplasesh
Faljen kërkon nga shpirti im*

*Unë e ndjej kupën e dashurisë
Do të derdhësh në shtatin tim
Fëmijën tënd të shohësh tek rritet
Në prehërin tim nga gjiri im*

*Heshtja e gjatë është mundim
Nuk të thërras më në emër
Unë e ndjej serish pret
Zërin tim të mërmërisë Zemër*

*Kot më thoshe Kosovare
Unë ty të dua sa Kosovën
Ti do njerëzit më shumë se mua
Më shumë se veten do gjithë botën*

Palloi

*Flakë tutje kurorën e vjetër
S'shkohet jeta në fron të rrejshëm
Mbreti im në mëkate i zhytur
Unë të dua ashtu siç je
Robëreshë tek këmbët do t'më qesh
Edhe lypës në varfëri mbytur*

*Përuhu pallua i bukur
Gëzofi puplor
Shpirtin s'ta shpëton dot
Flakë tutje krenarinë
Lutu për një strehë
Te i Madhi Zot*

Ti do të kthehesh

*Në kopshtin e rinisë sime
Dikur do të kthehesh
Ujë do të kërkosh
Nga gurra e hershme
Kur të të shoh prapë
Do më kthehet drita e jetës
Rëketë e lotëve të mi
Do të derdhen në gurrë
Përbuzjet e përplasjet
S'do i kujtoj më kurrë*

*Kur të vish që të kthesh
Të bukurën aromë
Që bashkë e shijuar
Në pranverën tonë
Petalet e trëndafilet
S'do derdhen më përtokë
Poleni tashmë i zhveshur
Do të endet sikur thotë
Mortja e Dashurisë
Tradhëtia
Gjarpër i tharë kot*

28 Prill '99

Kujtime

Qetësi nusërore

*Para tempullit Orëbardhë
Agu hapi portat mëngjesore*

*Këmbëmbarë u futem
Në atë të diel diellore*

*Para nesh shtrihej parajsa
Nën këngë engjëllore*

*Në bebzën e syrit tim
Çdo gjë ishte hyjnore*

*Por engjujt më zhveshën
Nga verbëria njerëzore*

*Gulçima e bishës më trazoi
Qetësinë nusërore*

Më kujtohet

*Në errësirën verbuese
Flisje përqart
Pa druajtje më rrëfeje
Vorbullen tënde
Më shtrëngoje ne gjumë
Të strukështa në gji
Lutesha për ne*

*Dridhështa
Djersiteshta
Unë për Ty*

5 Nëntor '99

Arna zemre

*S'më flisje për stuhinë
Që sillte psherëtimat
Të t'i zëvendësoja
Me frymën e shpirtit
S'm'u rrëfeve kurrë
As nuk deshe t'a dish
Se vrragët e së kaluarës
Desha të t'i arnoja
Me copa të zemrës*

Smirëzeza

*Nuri i virgjëreshës
Të përdalen e verboi*

*Me vorbullat smirëzeza
Serish më pengoi*

*Shtamba nga duart
Në kalldrëm më shpëtoi*

*Me shputat meskine
Në thërmia e coptoi*

*Me vrer të verdhë
Ujin kristalor turbulloi*

*Me shpirtin qazëm
Kroin e gëzimit shterroi*

Gërhamë

*Gërhamë e plakës
Më trazoi
Gjumin fëmijëror*

*Kyrokajtja e sorrës
Më mbyti
Në gushë gugurimën*

*Dora e shtrigës
Më theu
Kristalin e zemrës*

*Gremça hajdute
Më grabiti
Thesarin e jetës*

Shtriga magjistare

*Kakofonia e çmendur
Më shurdhoi veshët
Melodinë ma mbyti
Gjuhustra ziliqare
Në telat e ç'akorduar
Këngën m'a bëri fërtele
Në dorë m'a theu kitarën
Shtriga magjistare*

*Blozë m'i hodhi
Lëkurës së bardhë
Nga gishti ma vodhi
Unazën e artë
Në shtat m'a grisi
Petkun e sedeftë
Parasysh ma grabiti
Margaritarin në guacë*

Si nepërkë

*Kacavjerrur si merimangë
Rrjetën e trishtueshme
Mbi jetën time lëshoi
Epshet djallëzore shuajti
Me gjysmën e shenjtë*

*Në tempullin e bekuar
U përvodh rrëshqanasi
Si tenja më brejti
Trupin e sfilitur
Edhe thelbin e shpirtit*

*Zvarritur si nepërkë
Tinëzisht u fut
Në shtratin e nusërisë
M'a rrëmbeu kuroren
M'a kafshoi zemrën*

Demaskim

*Pëllumbi i bardhë
U shpuplua*

*Trëndafili i kaltër
U zhvesh*

*Agimet e arta
U faniten*

*Princi i ëndrrave
Iku kaluar*

*Në errësirën orëprerë
Të asaj pranvere*

U bëra i kanakë

*Pa datë pa orë jetoja
Ndërrimin e stinëve
Shihja
Në trungun e qërshisë
Dimri më gjeti në dritare
Tek të prisja
Të përcillja
Dhe lakmoja heshtur
Fluturimin e harabelit*

*Pranvera erdhi
Qershia shpërtheu bisqet
Lulëzoi*

*Por vera nuk më gjeti
Në vendin e vjetër
Bashkë me petalet
U derdhën përtokë
Edhe gëzimet e mia*

*Isha shpirtvogël
U bëra i kanakë*

Vetëm Ti

E unë ulokë

*Princi u demaskua
Ma grabiti kurorën
Besnikët më tradhtuan
ma thyen spektrin në dorë*

*E unë ulokë
Përbri fronit të përmbysur*

Unë mbeta aty

*Kur dashurinë tonë
Përplase përdhe
Përbri saj u përplas
E gjithë jeta ime
Unë mbeta aty
Prita gjithë rininë
T'ia dëgjoj edhe një zë
Nga buzët e mekura*

17 janar 2000

Pa strehë

*Fryma jote
Më frymëzonte
Buza jote
Më ushqente
Shpirti yt
Më fshikullon për vdekje
Qëkur në zemër
S'më jep strehë*

Kreshmë

*Tëksa me kreshma laj mëkatet
I falesha Zotit për të sotmen
I lutesha për të nesërmen
Rinia shtegtoi drejt harrimit*

*Më la kaçavjerrë
Në pikëpyetjen e fatit*

Duvaku i nusërisë

*Duvakun ma shndërrove
Në kurorë xhembore
Brenga gunë e zezë
Bardhësia poezi
Ujin e sheqerosur
Në gishtrinjë ma bëre shëllirë
Por sykaltroshin dhe ezmeren
Mbylla në romane histori*

Etje

*Nëpër shtigjet rinore
Has në burime të kristalta
Më djeg etja e pashuar
Larg teje kreshmoj*

*Në anën tjetër të botës
Për ty më përvëlon malli
Dua të vi por më gjymtove
Unë që atëherë çaloj*

*Shpresës për ne të dy
Serish dua t'i jap krahë
Përpëlitet buzë greminës
E unë vajtoj*

30 Janar 2000

Vetëm Ti

*Me fuçinë e dashurisë
Nga llastica në ikonë
Vetëm ti më shndërrove
Ishe i struktur në çdo qeli
Çerdhe shpirtin tim këshe
Se frymoje në çdo pore*

*Hape portën e zemrës
Mos më ler nën strehë
Gjithnjë në pritje të kotë
Merre dorën time
Ma jep dorën tënde
M'i mbledh këta lotë*

*Do të shetis botën
Të ta kthej prehjen
Shkëlqimin në dy sytë
Qiellit do t'i ngjitem
Që të shkëpus yjet
Jetën të t'a bëj dritë*

Ëndërrova

*Në shkretirën e pluhurt shkele
Me hapa të lehta ere*

*Në muzgun e jetës
Agim drite shpërtheve*

*Mbi trëndafilin e vyshtur
Një grushit vese derdhe*

*Në vjeshtën e rinisë
Pranverën e braktisur qëtheve*

Aty ku më le

*Kur thinjat ta kenë stolisur
Flokun tënd të flakëruar*

*Kur rrudhat në fytyrë
Moshë t'i ketë pikturuar*

*Prania jote do t'më ringjall
Ndjenjën e harruar të vashërisë*

*Nga buzët e tua emri im
Do të tingëllojë më i bukuri serish*

9 Shkurt 2000

Pritje

*Unë ende të pres
Të mbledhim bashkë
Yjet e shkapërderdhur
Nëpër qijejt e fatlumëve
Në qiell të kthejmë
Diellin e mbetur
Në një pranverë jete
Pa verë të harruar
Lus zogun sqepartë
Të ia thotë serish
Këngës vargshthurur
Të dashurisë sonë*

Durim

*Fjalët plumb
Që s'i bart as toka
Ende i ruaj në zemër
Me gjithë atë egërsi
Që atë ditë kur ti
Emrin ua ven shaka
Unë të iu buzëqesh
Nga zemra t'i fshij*

*Përbuzjet e përplasjet
Ndër erërat e jetës
Po i vuaj e bindur
Para zërit tënd
Një ditë kur të kujtohet
Se dikush po të pret
Mua do t'më gjejsh
Në të njëjtin vend*

Zemra të do

*Shpirti plagët kot t'i rrëfen
Ti ikjen nuk e ndërpret
As në kujtime nuk më gjen
Por kjo zemër të do shumë
Gjithnjë në ëndërra tek ti vjen*

12 Shkurt 2000

Ende

*Ende të kujtoj
Me kujtesën e fëmijës
Dhe të adhuroj
Me padjallëzinë e vashës*

*Ende të dua
Me dashurinë e nuses
Dhe të bindem
Me përunjësinë e robëreshës*

*Ende të dëshiroj
Oh me mallin e djetur
Por do të doja të të flak
Në harresën e moshës*

Kopshti parajzor

*Në kopshtin parajzor
Ku të pres me vite
Shtylla më janë engjëjt
Që përshëndesin durimin
Në shuplakë të Zotit
Kam gjetur folenë*

*Ti ende vërtitesh
Nëpër grigjat djallëzore
Lakmon vallen e mallkuar të djerrinave
Ku shtrigat shalojnë ujqërit
E gratë e shartuara me bushtra
Këllugen mbi vezët e mbarsura nga djalli*

Afër e larg

*Natyra qe veshur
Me petkë acari
Në ballin tim të fikur
Buloi djersa e ftohtë
Në krahëror mbloodha
Dy duar të ngrira
Zëvogël belbëzova
Afër është pranvera*

*Mbi supet e mbledhur
Lëshova këqën rëndë
Se sytë m'i verbonte
Edhe drita e zbehtë
Pafuqishëm laga
Shkrumbin e buzëve t'mija
Heshtur përshpërta
Larg është Dashuria*

*Shumë herë psherëtiva
Në pikëllimin tim
Shikimin hodha përpara
Të kaluarën lashë pas
Rrëqe lotësh derdha
Për të fundit herë
Kujtimet si nuse e mirë
Harresa i fshin gjithë gas*

Krahëtharë

*Krahëtharë mbetur
Shpatën dorëzova
Në atë fushëbetejë
U molisa u dërmova*

*Por shpirti romantik
Mbeti na atë luginë
Ngado që ike roje
T'a bëri dashurinë*

Lumi Lete

*Do të vijw koha
Mbi luginën e zemrës
Plot ëndërra të gjymtuara
Do të çel serish pranvera
Në buzë do të shpërthej
Buzëqeshja e gëzimit*

*Do të trokas ora
Kur mburojë e zemrës
Do të thyej shtizën e fatit
Lotët që derdhen me vite
Do ti marr me vete
Lumi i harrimit*

Mërgimtarja jote

*Kthehem jo siç ëndërroja
Vetë e dytë as vetë e tretë
Jam krahëtharë prehërzbrazët
Me një tufë kujtimesh të gjymtuara
Po vi vetëm por jo siç ika
Zemrën lashë aty ku e humba
Kthehem në çerdhen e vjetër
Me shpresa e gëzime të copëtuara*

*Portën e shekullit shtyva rëndë
Në rrethojat ku varrosa lumturinë
Që t'kthehem në viset ku u linda
Unë Dallëndyshja Krahëcunguar
Le një plagë dhe gjej një varr
Babai s'më pret në vatrën e vjetër
Në vend të tij do ta puth dheun
Unë Mërgimtarja e Përvëluar*

12 Prill 2000

Kujtesë

*Mendja ime ngreh dorë
Para yshitjes tënde
Kujtesë
S'ka këmbë për promenada
Në bashqë të shpyllzuara
Po largohem kaluar
Mbi krahë të ardhmërisë
Të zhdruk me përsosmëri
Mëkatet e mija*

15 Prill 2000 Dilingen

Kthimi i dallendyshes

Panoramë vere

*Mes qiellit të kaltër dielli brerore
Bari në fusha valëvitet butë butë
Nëpër grunaja plot kallinj të artë
Lulëkuqet valëviten në çdo skutë*

*Befas lëkundet një këngë baritore
Fyelli jehon në kreshita e livadhe
Delet kullostin nëpër lendina
Mes tyre baresha porsi një sorkadhe*

*Fytyrën e bukur era ia miqson
Fluturat pushojnë mbi flokët e zeza
Llërët e bardha e kush s'ia lakmon
Me farfurime bukurezash*

*Shih si ka ngulitur bebëzat në shuplakë
T'ja rrëfejë krushka rrugën që s'e dinte
Bariu matanë priste mbi një kreshitë
Bukureza nusen e bukur t'ja shpiente*

23. Korrik 2000 Bogë-Rugovë

Ti je e vetmja dritë

*Kur dikur kapërceva qiellin
Kalëruar mbi ylberin
Kush më verboi Dashuri
Kur më ishe kaq pranë
Ç'fuqi e ligë të lidhi gjuhën
Që s'më the se ti u ktheve
Kush të mbërtheu gjymtyrët
Që nuk erdhe fare tek unë*

*Përse me muaj dhe me vite
M'ju fshihesh syve pamëshirë
Në bebzat e tyre të ruaj gjithnjë
Për ta Ti je e vetmja dritë
Vallë gjithë jetën do t'i ikësh
Shpirtit tim të përvëlur
Ti e di se në çerdhën e zemrës
Flen dhe zgjohesh natë e ditë*

08 Mars 2001 Strellc

Besnikëri

*Buzët gjithë rininë
Do të thërrasin emrin tënd
Në shekullin e gjatë
Zemrën për ne do të djeg
Edhe në muzgun e jetës
Lotë për ne do të derdh
Vetëm para Zotit
Tradhëtare të mos jem*

*Trupi as në vdekje
S'do t'më prehet i qetë
Eshtrat do të trondisin
Tutje tokën e shkrretë
Dheun e varrit shpirti
Do të m'a çoj peshë
Hija do të kërkojë hakun
E zemrës së vvarë në jetë*

Nuse pa kurorë

*Frymën e shenjt në shtat
Tufani jetës shkapërderdhi
Jetën e re që duhej të pikonte
Ç'grusht i zi në bark ma dërmoi
Dora e jetës më ndrydhi zemrën
Goditja e fatit m'i theu gjymtyrët
Dita qobzezë gëzimin tim
Me velin e zi pamëshirë mbuloi*

*Një copë zemre m'u shkëput
Kur shtriga shtatin ma shitoi
Vesa e shenjt para kohe
Më pikoi nga trupi i hollë
Gjuhëlidhur e buzëemitur
Mallkova atë burim vese
Vërshoi nëma e u ngujua
Pjellë mëkati në një bollë*

*Nuse shtatzënë më braktise
Për shtrigën me lungë
Buzëplatur e fatprerë
Ju bashkova zanave të malit
Për unazën e këputur
Që kurrë s'na lidhi kurorë
Për foshnjën tonë të humbur
Që zëvendësove me një doç mëkati*

20.Mars.2001

Zotin kam strehë

*Në lutje të gjata errem e gdhihem
T'mi vesh balsam thelbit të shpirtit
Nga goditjet e paprera
Që mbi dhembje më hapin plagë
Zhgënjimi keq m'i ka lidh nyjet
Frytin e lutjeve ma grabiten
Foshnja e tij në strofull shtrige
Në gropë të zemrës më ka hap varr*

*Sa herë bie Ti Zot më ngritë
Netëve të errëta më bën dritë
Në Dorën Tënde është prehja ime
Të kam shtrat të kam mbulojë
Mirësinë Tënde të paskaj
Mëkatarët vallë ta gëzojnë
Unë besimtarja e gjorë
Gjithnjë në ëndërra të jetoj*

*Grusht i jetës panda godit
Egërsisht m'i verbon sytë
Dritën Tënde që praron botën
Ngadhënjimi i djallit megjullon
Yllin e Shenjtë dritëruar
Shpresëfikur kërktoj serish
E kapur fort për Litarin Tënd
Verbërija njerëzore s'më trishton*

23.Mars 2000

Rini mynxyrë

*Mos me pyetni mua te sfilituren
Purse zemren pa faj bujrgosa
Ishte e çiltër e kthjellët si vesa
Mbujtur e gatuar në mirësi
Mos më gjykoni përse në thelb
Çdo hap thika të egra i vura
Me vuajtje të përgjakshme
Shpagova jetën këtë Mëkat të Zi*

*Mos m'ia përtërini shkrymbin zemrës
Mos m'ua gërrithni plagëve dregzën
Heshtur më përcillni edhe ndër varre
Kur n'qepallë stepur të mbetet shikimi
Trupin në arkivol kur t'ma shtrini
Mos m'vajtoni por lutuni për mua
Ato duar që m'u prenë në jetë
Të më zgjaten drejt amshimit*

*Trupi i dergjur do të gjej prehjen
Vetëm në varr ku mbretëron heshtja
Rinia ime ishte Mynxyrë
Në gur të varrit gdhendni mbishkrim
Kur në Ditën e Madhe të Gjykimit
Zemra në shpirtin tim të ankohet
Aty të gjithë do ta kuptoni
Domethënjen e Amanetit tim*

27.Mars 2001

Muri i shenjt

*Kur fati dikur na pat buzëqeshur
Me thonjt e duarve qendisa diellin
Mes botërave që ndanin oqeanet
Shtriva krahët t'u bëra urë
Me gërsheta gardh kurore thura
Riskun e jetës gurw kalaje bëra
Në themele palosa ëndërrat
Foshnjen tonë flijova në mur*

*Kur të hapen portat e rruzullimit
Vetëm një dritë botën praron
Gjurmët e mëkateve ndaj shpirtit tim
Do t'i shohësh në Librin e Shenjtë
Do të rrëfëhet Syri i Drejtësisë
Që gjithë jetën me mua ka qarë
Në ballë mallkimit do të të vulos
Zoti i Madh që vran e kthjell*

Aty

*Sa herë vë duart në bark
Prekja shpluhuros kujtimet
Prehëri i zbrazët
Me kujen shurdhe
Mallkon shterpësi
Dëshpërimi i dështimit
Brumose e gatuhet me lotë
Aty
Në magjen e zemrës sime
Ku mbarset e pjell mynxyra*

Tretur në natë

Nënë

*A që dëgjuar ndonjëherë
Të vritet zemra
Vetëm pse dashuron
A që provuar si vetmohet gruaja
Pa u nusëruar mirë*

Zgjodha verbërisht nënë

*Me sytë e zemrës
Dashurova çiltër
Shpresova kuroren
Pse më linde besnikë
Mbeta
Pre e dashurisë tradhtare*

Tash jam tretur në natë

*Velloja më mbet shkret
Kërpudha myku
Në shtratin e larë me lotë
Fotografitë
M'i ka mbuluar pluhuri
Ai nuk deshi t'i ruaj
As për kujtim*

Prandaj nënë

*Mos më kërko më ndër nuse
Do të martohem me mortjen
Veshur e tëra me lule
Në varreza do të kurorezohem*

*Mos m'a dëshiro as jetën
Do të iq atje ku bie aromë parajse
Praruar në dritën hyjnore
Meloditë engjëjllore
Të m'a përkundin shpirtin*

*Do të shkroj nënë
Oh të çmallem
Me babën zemërplasur
Mallkuar çoftë jeta
Në këtë botë mëkatare*

28 Tetor 2001

Për Ty

Ishulli i shpresës

*Në këtë mugëtirë
Pulëbardhat
Përgjithmonë u arratisen
Tufani përmbysi anijen time
E mua
Vetëm në frymën e fundit mu kujtua
Ishulli i Shpresës së Mirë*

*Lakmova t'ia prekja
Gjelbërimin e virgjër
Me vesën e sheqerosur
Mbuluar
Teksa shiu i kripur
Më kallte buzët
E dallgët e çmendura
Më bartnin kërmën në liman*

Vallëzim gjarprinjsë

*Desha të sjell pranverën
Të bëj kopsht një djerrinë
Në vend të rërës
Të bënin shtrat lumenjtë
Ku kryroqasnin qorbat
Të këndonin kanarinat
Në atë botë të çmendur
Ku vallëzonin gjarprinjtë*

*Të zhbija kërpudhat
Të mbillja jorgovanë
Ku mbinin hithërat
Të shpërthenin jaseminë
Aty ku tokën
Përjargnin kërmintë
Të lindeshin të rriteshin
Të vlonin kërtinjtë*

Ai

*Prapë dua t'i shkruaj
Gjatë për dashurinë
Më këputen duart
Më vdesin gishtrinjë*

*Me penë e lutje
Ia ndjelli beqimin
Muzat më thonë
S'e vlen as mallkimin*

*Ai shpirt i çoroditur
Zemër e gjymtuar
Un' i bastardhosur
Dy syshë i verbuar*

28. Korrik 2001

Flapa kqhe

*Kur tradhwtia me vrau shpirtin
Do të të fshija nga kujtesa
Pa më të voglin ngurim
Do ktheja kohën të t'thëm Shko
Sa s'është vonë e përgjithmonë
Kur nuk ka fund as fillim*

*Yllin e Fatit do të t'a grabisja
Të nemitur e duarzbrazët
Do të të zhysja në trishtim
Dashurisë zëngjirur kur t'i këndoje
Atë këngë të shurdhër
Do të t'a flakja në harrim*

Jeta s'është më Jetë

*Kujto moj Kohë e Harlisur
Pesë vjet të hidhura
Nga trungu i jetës m'i shkëpute
Mos harro Fat i Harbuar
Se çdo orë më mbyl ngadalë
Qëkur në dallgë të zeza më fute*

*Ditët e mia s'janë më ditë
Nga mëngjesi në tjetrin mëngjes
Bota ime është e verbër
Me dritën që vdes*

*Kjo është jeta ime
Që vetëm unë jetoj
Unë nuk jam më
Si i gjithë njerëzimi
Rinia e zezë çdo ditë
Më hap plagë të re
Kështu jetoj Jetën
Në formë perëndimi*

05. Gusht 2001

Atëbotë

*Gërshetat e gjata
Shkryfëroja pa ngurim
Kaçurrelat era
Si nënë m'i ledhatonte
Tani mosha si njerjë
Më kreh me gërhanë
Ma zbeh nga fytyra
Nurin që verbonte*

*Syve të zez ulli
Buzëve lulështrydhe
Iu gëzohem në kujtime
Nga vera e rinisë e dehur
Kur në pasqyrë shoh
Bukurinë e zbehur
Jam buzëvrrarë syfikur
Lotët më bëjnë esëll*

Legjendë

*Ditën thurja shporta
Natën mblidhja yje
Tja shwndrisja rrugën
Princit tek kalëronte
Koha haparëndë
Më bindi pafjalë
Princi në kali të bardhë
Në legjenda jetonte*

*Kështjellën e bukur
Shembi fatqësija
Çdo gur i ëndërrave
U rrokullis në greminë
Kurorën e shpresuar
S'trashëgova kurrë
Në luginën e pritjes
Kot varrosa rininë*

Kotësi

*Gjithë rininë këmbkëputur
Shtigjeve vetëm u zvarrita
Kotësia e bredhjes sime
Sytë e zez m'i treti në natë
Kot zgjata duart e zbraza
Ta gjej ndër qijejt e kaltër
Sytë e tij u zhytën e u mbytën
Ndër valë të detit në shtrëngatë*

*Moj mëndje e shkretë
Që kurrë s'të lashë të qetë
Sa çudi si s'më braktise
Në arrati të kërkosh pushimin
Rrëmbyer nga kthetrat e çmendurisë
Ti s'më lejove të marr dhenë
Këmbëzbathur flokëshprishur
Të trishtoj gjithë njerëzimin*

Përse më ike

*Po t'më ktheheshe mëqatar
I penduar për tradhëtinë
Mishit të zhveshur lëkurë tharë
Në kocka do ia ndizja dashurinë*

*Të coptuar në njëmijë copa
Aromën e trupit do t'a njihja
Të gjymtuar këmbësh e duarsh
Bukurinë e vjetër do t'a përtërija*

*Po të dëbonin mes shkrretirës
Me ty do vija ta prisja vdekjen
Me thonjtë e mi do rrëmoja tokën
Të gjeja burime të t'a shuaj etjen*

*Gjakun e zemrës do të ta bëja
Ballsam për buzët e shkrumbuara
Shkrumbin e trupit do të ta vëja
Mehlem mbi plagët e pezmatuara*

*Më parë se t'i dëgjoja rënkimet
Zemrën time do ta ndrydhja në gji
Më parë se të t'shijja të përvuajtur
Do t'i nxirrja dy sytë e mi*

*Po të ishe tretur kaherë nën dhe
Varrit tënd do t'i qëndroja besnikë
Ti për së gjalli e le të ve
Dashurinë time dhe ike...ike*

20. Gusht 2001

Oh

*Më mirë të të palosja
Me këto duar në dhe
Se të thërmoj gishtrinjtë
Tek pragu i shtëpisë
Kojrillë e mjerë në pritje
Nga larg të t'i dëgjoj hapat
Më mirë në krematoriume
Të bëheshe shkumb e hi*

Hapa mizorë

*Mishi në dhëmbje
Më është pjekur
Lëkura më është regjur
Eshtrat më brehen heshtur
Ndërsa kafkë rrokulliset
Nëpër vitet e zisë time
Mbi plagët e zemrës shkelin
Hapat e tu mizor*

Njëditëzaj

*Ahu i zemrës sime
Do t'i mbërthej gjymtyrët
Bryma e acarit orëzi
Do të t'a ngrij shikimin
Me blozë mbuluar
Do të kujtosh
Brishtësinë e trupit tim
Të burgosur në vetmi
Do të kërkosh faljen e atij
Që nën hijen i blirit
I dergjen eshtrat me mote*

25 Gusht 2001

Epilog

Grua as engjëll

*Pas rënjes pingult hi
Të prirur nga djalli
Shpirti i paepur
Në çipin e jetës
Mbeti kaçavjerrë
Unë pas asaj
Grua as engjëll
Sirenë në tokë
Zanë në ujë*

Çdo gjë e Asgjë

28 Tetor 2001

Fund

Ajete Sh. Beqiraj

Tretur në natë

poezi

Botoi dhe shtypi: "VATRA", Shkup

Redaktor: Visar ZHITI

Recenzent: Ali PODRIMJA

Ilustrimet & kopertina: Ajete Sh. BEQIRAJ

Botues: Halil ZENDELI

